VENDIM
Nr. 29, datë 19.5.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 30.3.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 8 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Doriana Daraku

SUBJEKT I INTERESUAR: Bashkia e Tiranës

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-2989 (304), datë 14.5.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 49–52, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27–30 dhe 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Altina Xhoxhaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 892, datë 2.7.2008 të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, kërkuesja është emëruar në pozicionin e specialistes në Sektorin e Auditimit pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm. Pas një viti në detyrë ajo është konfirmuar si nëpunëse civile në bazë të akteve ligjore në fuqi për statusin e nëpunësit civil.

2. Me urdhrin nr. 1262, datë 26.10.2011 të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, kërkuesja është liruar nga detyra, për shkak se është punësuar në kundërshtim me kushtet e përcaktuara për audituesin e brendshëm. Këtë vendim kërkuesja e ka kundërshtuar në Komisionin e Shërbimit Civil (*KSHC*).

3. Me vendimin nr. 247, datë 22.12.2011, KSHC-ja ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës, shfuqizimin e aktit nr. 1262, datë 26.10.2011 të kryetarit të Bashkisë për lirimin e kërkueses nga detyra dhe sistemimin e saj në një pozicion tjetër. Kundër këtij vendim ka paraqitur ankim në gjykatë Bashkia e Tiranës.

4. Me vendimin nr. 74, datë 12.7.2012, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 247, datë 22.12.2011 të KSHC-së.

5. Me vendimin nr. 00-2015-2989 (304), datë 14.5.2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 247, datë 22.12.2011 të KSHC-së dhe të vendimit nr. 74, datë 12.7.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë.”*.

II

6. ***Kërkuesja Doriana Daraku*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë

sipas objektit dhe paraqet këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

6.1 Kolegji Administrativ nuk ka përcaktuar se çfarë shkeljesh janë bërë nga KSHC-ja dhe Gjykata e Apelit në vendimmarrjen e tyre. Ai nuk ka arsyetuar shkaqet për ndryshimin e këtyre vendimeve, si dhe nuk ka përcaktuar se cilat dispozita të ligjit material ose procedural janë keqzbatuar.

6.2 Kolegji Administrativ ka shkelur nenin 49 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e punësimit. Vlerësimi i tij ka qenë i gabuar, pasi marrëdhëniet e punës së kërkueses kanë filluar në datën 2.7.2008 dhe rekrutimi është bërë në bazë të konkursit, siç përcaktohet në ligjin për nëpunësin civil. Po ashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit nuk ka konstatuar shkelje për emërimin e kërkueses në atë pozicion.

6.3 Vlerësimi që i ka bërë Kolegji Administrativ urdhrit të kryetarit të Bashkisë është i gabuar. Edhe pse në pikat 17–22 të vendimit përmenden të drejtat që ka një nëpunës civil, në pikën 23 të tij kjo e drejtë i mohohet kërkueses. Shkeljet në procedurën e konkurrimit nuk janë bërë për faj të kërkueses, prandaj KSHC-ja ka vendosur që ajo të sistemohet në një pozicion tjetër ku plotëson kriteret e konkurrimit, fakt që nuk është vlerësuar nga Gjykata e Lartë.

6.4 Kolegji Administrativ i ka mohuar kërkueses të drejtën e mbrojtjes, të drejtën e informimit dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke përcaktuar se një nëpunës civil nuk ka të drejtën e mbrojtjes në momentin që ai cenohet në mënyrë të padrejtë dhe i mohohet e drejta e punësimit.

7. ***Subjekti i interesuar, Bashkia e Tiranës***, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim para Gjykatës lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

8. Gjykata vëren se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

9. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kërkuesja ka pretenduar në kërkesë se Kolegji Administrativ nuk ka përcaktuar se çfarë shkeljesh janë bërë nga KSHC-ja dhe Gjykata e Apelit në vendimmarrjen e tyre, nuk ka arsyetuar shkaqet për ndryshimin e këtyre vendimeve, si dhe nuk ka përcaktuar se cilat dispozita të ligjit material ose procedural janë keqzbatuar. Sipas saj, vlerësimi i Kolegjit ka qenë i gabuar, pasi marrëdhëniet e punës së kërkueses kanë filluar në datën 2.7.2008 dhe rekrutimi është bërë në bazë të konkursit, siç përcaktohet në ligjin për nëpunësin civil. Po ashtu, kërkuesja pretendon se Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se shkeljet në emërim nuk janë bërë për faj të saj, prandaj KSHC-ja ka vendosur që ajo të sistemohet në një pozicion tjetër ku plotëson kriteret e

konkurrimit. Duke i vlerësuar këto pretendime në bazë të standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se në thelb ato kanë të bëjnë me çështje që lidhen me mënyrën e vlerësimit dhe të interpretimit të ligjit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Në kushtet kur këto pretendime kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për rrjedhojë, kërkuesja nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me këto pretendime.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve

11. Sipas kërkueses, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka mohuar të drejtën e mbrojtjes, të drejtën e informimit dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

12. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr. 31, datë 26.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë, pa dëgjuar pretendimet e komentet e palës tjetër, e bën procesin gjyqësor të cenueshëm. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe nocionin se të dyja palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet e argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë që palët në një seancë civile apo penale të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra (*shih vendimin nr. 17, datë 18.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se me miratimin e ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i cili është legjislacioni i ri procedural i zbatueshëm në këto lloj gjykimesh, është parashikuar, mes të tjerash, edhe procedura e gjykimit të këtyre çështjeve. Sipas nenit 59 të ligjit nr. 49/2012 pala kundër së cilës është bërë rekurs mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit dhe mosparaqitja e kundërrekursit brenda këtij afati sjell humbjen e së drejtës për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë. Dërgimi i dosjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve të rekursit e kundërrekursit palëve ndërgjyqëse në proces (neni 60). Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 61 i ligjit parashikon se ai bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe

orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve dhe sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve (neni 62).

16. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekte të gjykimit rezulton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit të interesuar, Bashkisë së Tiranës, të datës 27.7.2012. Sipas dëftesës së komunikimit të rekursit të datës 5.12.2012, nuk rezulton që ai t'i jetë njoftuar kërkueses, por është marrë në dorëzim nga një shtetas tjetër (A.K.) dhe nuk ka asnjë shënim për sa i takon lidhjes së tij me kërkuesen. Me vendimin e datës 7.4.2015, gjyqtari relator i çështjes ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në datën 14.5.2015, duke urdhëruar sekretarinë të bëjë njoftimin e palëve për orën dhe datën e caktuar. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 14.5.2015 rezulton se Kolegji Administrativ ka vlerësuar se palët kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit dhe ka marrë në shqyrtim vetëm shkaqet e ngritura në rekurs, ndërkohë që nuk rezulton që kërkuesja të ketë paraqitur kundërrekurs ose parashtrime me shkrim në kundërshtim të pretendimeve të palës tjetër. Përfundimisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2989 (304), datë 14.5.2015, ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit nr. 247, datë 22.12.2011 të KSHC-së dhe të vendimit nr. 74, datë 12.7.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë*.".

17. Gjykata rithekson dallimin mes shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi ose jo i kritereve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhe shqyrtimit të çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh sipas ligjit nr. 49/2012. Megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata thekson se Gjykata e Lartë ka detyrimin jo vetëm të njoftojë rregullisht palët për procesin, por edhe t'u sigurojë atyre mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve. Për këtë qëllim Gjykata e Lartë duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen.

18. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar të parashtruara në rekurs dhe duke mos i dhënë mundësinë kërkueses që të paraqiste pretendimet e saja në lidhje me çështjen, e ka vendosur atë në një pozitë të pabarabartë në raport me palën tjetër. Duke mos marrë masat për t'i garantuar kërkueses të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë së paraqitjes së prapësimeve të saj, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses është i bazuar dhe kërkesa duhet të pranohet.[1]

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

[1] Gjyqtari V. Kristo votoi edhe për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, sipas qëndrimit të shprehur në Mendimin Paralel të vendimit nr. 27, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

VENDOSI:

Pranimin e kërkesës.

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-2989 (304), datë 14.5.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj